

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

Procesverbal për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës së prokurimit në lote me objekt “ Blerje materiale ndihmëse për prodhim dhe shtrim asfalti ”

I mbajtur sot në datë 01.06.2026 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt “ **Blerje materiale ndihmëse për prodhim dhe shtrim asfalti** ”, me fondi limit **24,144,000 (njezet e kater milion e njeqind e dyzet e kater mije) leke me TVSH.**

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është **253,268 (dyqind e pesedhjetë e tre mije e dyqind e gjashtedhjetë e tete) Euro**

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 02.06.2026 95.33 euro

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote **sa herë kjo është e mundur.** Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”*

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

Së pari, kemi të bëjmë me të njëjtën familje mallrash, pra me natyrë të njëjtë, që në thelb i përkasin të njëjtës kategori.

Së dyti, Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish-komunave, pra zonat rurale. Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin mirëmbajtjen e rrugëve urbane dhe rurale, e rrjetit të ndriçimit publik, e sinjalistikës rrugore (vertikale dhe horizontale, me apo pa ndriçim) si dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese dhe vaditëse. Theksojmë se një nga objektet kryesore dhe të rëndësishme të veprimtarisë së saj është mirëmbajtja e shtresave asfaltike rrugore, si urbane dhe atyre rurale. Në funksion të kësaj veprimtarie AK-ja disponon një impiant për prodhimin e asfaltit, ku aditivi dhe oksidi janë materiale të domosdoshme për prodhimin e tij. Gjithashtu, prajmeri është një element tjetër kryesor për shtrimin e asfaltit.

Së treti duke u nisur nga vetë dinamika e veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor, e cila dikton nevojën për prajmer edhe në disa vende e kantiere në të njëjtën kohë, që ndodhen në largësi të

konsiderueshme nga njëri-tjetri për shkak të territorit të gjerë ku operon AK (territori i Bashkisë Tiranë), në funksion të realizimit me sukses të detyrave të tij gjykon se për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, ku lëvrimi i mallit nga operatorë të ndryshëm nuk është i favorshëm, sepse do të shkaktonte vështirësi AK-së duke u shoqëruar me kosto shtesë, vonesa në kryerjen e furnizimit dhe si rezultat mosrealizimin e punëve sipas objektivave të AK-së.

Si përfundim, për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, kjo procedurë për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me të njëjtën natyrë mallrash gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë, në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për sigurimin e mallit në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.

NJËSIA E PROKURIMIT